RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO

Nr. 0004/23

Data 10.01.2023

PRISHTINË

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në përputhje me nenin 29 dhe nenit 37 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, nenit 20 Ligjit Nr. 06/L-021, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, të nenit 34 të Statutit të RTK-së, të nenit 7 dhe 8 të Rregullores për Punën e Bordit të RTK-së, të nenit 27 të Rregullores së Auditimit të Brendshëm, në bazë të neneve 4 dhe neni 6 i Udhëzimit Administrativ MF -nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, si dhe në bazë të Vendimit të Bordit të datës 25.03.2022, Bordi i RTK-së përmes votimit online më 08.01.2023 merr:

## VENDIM

- Për caktimin e pagës apo shtesave të kryesuesit dhe anëtarëve të Komitetit të Auditimit të RTK-së, si vijon:
  - Kryesuesi i Komitetit të Auditimit merr pagesën në shumën 120 euro për një mbledhje.
  - Anëtari i Komitetit të Auditimit merr pagesën në shumën 100 euro për një mbledhje.
  - Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit do te paguhen për më së shumti 12 mbledhje brenda një viti kalendarik.
  - Komiteti i Auditimit të Brendshëm duhet të takohet jo më shumë se një (1) herë në muaj.
  - Pagesa e kryesuesve dhe anëtarëve të Komitetit të Auditimit bëhet nga subjekti i sektorit publik që e themelon komitetin.
- Ky vendim shfuqizon të gjitha vendimet e mëhershme të Bordit të RTK-së që kanë të bëjnë me pagën apo çfarëdo kompensimin financiar për Kryesuesin dhe anëtarët Komitetit apo Komisionit të Auditimit.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kryetar i Bordit të RTK-së**
**Besnik Boletini**

**Vendimi iu dërgohet:**
- Anëtarëve të Bordit të RTK-së;
- Anëtareve të komitetit të auditimit;
- Sekretarisë së Bordit;
- Drejtorit të Përgjithshëm
- Administratës

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS • RADIO TELEVIZIJA KOSOVA • RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RTK